

REPubLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3138 Prot.

Tiranë, më 19 . 10 .2023

**VENDIM QARKULLUES**


Nr. 64 , datë 19 . 10 .2023

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE VJETOR 2024-2026 TË  
VEPRIMTARISË SË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM, NË  
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**


Bazuar në nenet 49 dhe 116 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenet 51, shkronja “m” dhe 53, pika 2 të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; në nenin 43 të Rregullores së UMT-së; në Rregulloren e Bordit të Administrimit; në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar; në shkresën e MFE-së nr. 16696 prot., datë 18.09.2023 “Mbi përgatitjen e planit strategjik dhe vjetor të veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm për vitet 2024-2026”, si dhe në shkresat nr. 2969/2 prot., datë 05.10.2023 dhe 2969/4, datë 19.10.2023, të Përgjegjësit të NJAB në UMT, në mënyrë qarkulluese, Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Planin Strategjik dhe Vjetor 2024-2026 të veprimtarisë së Njësive të Auditimit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, sipas planit strategjik të propozuar bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Njësia e Auditimit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MONIKA FIDA  
  
ALBANA GJINOPULLI

KRYETAR  
ZAMIR AGËRI  
  
ANËTARE  
VERA OSTRENI  
  
ANIS THODHORJANI


ALTINA XHAFERI  
  
ENDRIT YZEIRAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**PLANI STRATEGJIK 2024-2026 DHE  
VJETOR 2024 I VEPRIMTARISË SË AUDITIT  
TË BRENDSHËM TË UMT-SË**



**UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË**

***Tetor 2023***





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**Plani Strategjik dhe Vjetor i veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm të  
Universitetit të Mjekësisë për periudhën 2024-2026**

**Hyrje**

Bazuar në germen "c", të nenit 14, të Ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"; Kapitullin III, Planifikimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, Njësia e Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Mjekësisë, ka hartuar Planin Strategjik 2024-2026 dhe Planin Vjetor 2024.

Universiteti i Mjekësisë, është institucion i Arsimit të Lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. UMT-ja ka në përbërjen e tij 4(katër) njësi shpenzuese, 1(një) Rektorati , 3 (tre) Fakultete.

Misioni i UMT-së është të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë e të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit shkencor, të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor, të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar e rajonal; të mbështesë interesat strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e Arsimit të lartë.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) është pjesë e strukturës dhe organikës së Universitetit të Mjekësisë; është e ngritur në nivel sektori, e përbërë nga përgjegjës 1(një) dhe 2(dy) specialistë auditimi.

NJAB-ja, është funksionalisht e pavarur dhe raporton në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek Bordi i Administrimit të UMT-së.

**I. PLANI STRATEGJIK PËR PERIUDHËN 2024-2026**

- Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i NJAB-së

Qëllimi i Planit Strategjik 2024-2026 është përcaktimi i angazhimeve që do të ndërmerren nga struktura e auditimit të brendshëm të UMT-së për periudhën e ardhshme 3-vjeçare, duke e përditësuar çdo vit këtë dokument, për të siguruar një përshtatje të tij me dinamikën e objektivave, synimet e Universitetit dhe me burimet njerëzore në dispozicion të shërbimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB). Në këtë plan strategjik do të programohen



veprimtaritë kryesore të planifikuara për t'u kryer në periudhën 2024-2026, në mënyrë që të sigurohemi që sistemet/fushat e identifikuar me risk mbulohen me auditim gjatë kësaj periudhe.

Gjatë hartimit të këtij plani strategjik është bërë i mundur optimizimi i gjithë fazave të procesit, duke filluar me universin e auditimit, vlerësimin e riskut, frekuencën e auditimit dhe përlllogaritjen e burimeve të auditimit.

Misioni i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në UMT është të përmirësojë dhe mbrojë vlerat e institucionit, duke ndihmuar në arritjen e objektivave, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut si dhe vlerësimin e proceseve të kontrollit të brendshëm në Institucion.

- Organizimi i NJAB-së dhe kuadri ligjor

Njësia e Auditimit të Brendshëm në UMT është pjesë e strukturës dhe organikës së këtij institucioni, dokument i cili është miratuar me Vendimin të veçantë nga strukturat drejtuese të UMT-së, "*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së UMT-së*". Referuar Vendimit, njësia është ngritur në nivel Sektor, i cili përbëhet nga 1 (një) përgjegjës dhe 2 (dy) specialistë.

NJAB-ja, është funksionalisht i pavarur dhe raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë tek Bordi i Administrimit të UMT-së

Njësia e Auditimit të Brendshëm në UMT, ushtron veprimtarinë mbi këtë bazë ligjore:

- Ligjin nr.80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimit Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë*".
- Statuti i UMT-së, miratuar me vendimin e BA-së së UMT-së nr. 36 datë 11.09.2018 dhe të Senatit Akademik nr.11, datë 11.02.2019 .
- Rregullorja e brendshme e UMT-së, miratuar me vendimin nr.59, datë 27.06.2022 dhe ndryshuar me vendimin nr.77 datë 30.06.2023,, të Senatit Akademik .
- Karta e Auditit të brendshëm, miratuar nga BA-ja me vendimin nr. 67 datë 19.12.2022 prot me nr. 4487/3 datë 19.12.2022.
- Ligjin nr.114/2015 datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", i ndryshuar;
- Manualin për Auditimin e Brendshëm, i miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*"; i ndryshuar.
- Kodi i Etikës, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 86, datë 10.12.2015 "*Për Miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik*".

- Objektivat strategjike

Objektivat strategjike kryesore të njesisë publike janë :

- a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor.
- b) të formojë specialistë të lartë në disa fusha, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
- c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfitur nga arsimiti i lartë dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës;
- ç) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare;
- d) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit;
- dh) të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;





e) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.

**Objektivat strategjike kryesore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm janë :**

- Përgatitja e planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, duke ruajtur frekuencën e auditimit dhe duke u bazuar në vlerësimin objektiv të riskut.
- Vlerësimi i përshtatshëm dhe efektivitetit të sistemeve të kontroleve në përmbushje të misionit të Institucionit.
- Dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të UMT-së.

*Objektivat e Sektorit të Auditimit të Brendshëm:*

- Përfshirja në planin (1+2) e të gjithë subjekteve, duke u fokusuar në identifikimin e fushave, të cilat kanë ndikim në arritjen e objektivave të përcaktuara si më sipër për UMT;
- Programimi dhe kryerja e auditimeve në bazë të planit të miratuar, duke u munduar të ruhet frekuenca e auditimit, vlerësimin e riskut dhe nivelin e materialitetit në raport edhe me majftueshmërinë e burimeve të auditimit.
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm lidhur me përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm, sipas sistemeve fushave të identifikuara për auditim.
- Ndjekja e vazhdimësisë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.
- Identifikimi i subjekteve

Referuar strukturimit të UMT-së, subjektet që NJAB-ja duhet të auditojë janë institucione arsimore.

Asnjë prej institucioneve të varësisë së UMT-së, nuk ka në përbërje të strukturës dhe organikës Njësi të Auditimit të Brendshëm, për këtë arsye janë identifikuar të gjitha institucionet e varësisë si subjekte auditimi, sepse shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga struktura e NJAB-së në UMT.

Shpërndarja e subjekteve të identifikuara për auditim gjatë këtij 3-vjeçari është bërë duke marrë në konsideratë nivelin e vlerësimit të riskut, përlogaritjen e burimeve të auditimit si dhe frekuencën e auditimit.

Institucionet e varësisë së UMT-së janë gjithsej 4 (katër); në të cilat përfshihen:

- 1- Rektorati
- 2- Fakulteti i Mjekësisë (FM)
- 3- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT)
- 4- Fakulteti i Mjekësisë Dentare (FMD)

- Identifikimi i fushave / sistemeve prioritare

Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare është kryer sipas informacionit të marrë nga planet e mëparshme strategjike, gjetjeve kryesore të paraqitura në raportimet vjetore të viteve të fundit si dhe mënyrës së strukturimit dhe organizimit të menaxhimit financiar në çdo subjekt të identifikuar.

Sistemet kryesore të identifikuara në institucionet me risk të lartë janë:

- Sistemet e proceseve organizative: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore
- Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit;
- Sistemi i krijimit dhe përdorimit të ardhurave dytësore;





- Sistemi i prokurimeve publike/konkurrimit publik;
- Sistemi i pagesave;
- Sistemi i raportimit dhe kontabilitetit financiar, duke përfshirë detyrimet e prapambetura dhe menaxhimin e aktiveve;
- Sistemi i procedurave mbi përdorimin e fondit të bursave;
- Sistemi i procedurave mbi pranimet sipas kuaotave të miratuara dhe mbledhja e tarifave të shkollimit;
- Sistemi i procedurave mbi normat mësimore dhe pagesat mbi orët mbi normë;

Bazuar në gjetjet e auditimeve të ushtruara gjatë viteve, një rëndësi mjaft e madhe do t'i kushtohet auditimit të sistemit të prokurimeve publike, mbledhjes së tarifave të shkollimit, pagesave mbi orët mbi normë si dhe të gjitha njësive të cilave u akordohen fonde për projekte.

Pavarësisht se në pasqyrat bashkëlidhur me nr.1 dhe nr.3 nuk është përcaktuar si sistem i identifikuar, në çdo angazhim auditimi, një nga drejtimet e auditimit ka qenë dhe do të jetë vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

#### • Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Identifikimi dhe vlerësimi i përgjithshëm i riskut është kryer pas rishikimit të Formatit Standard Nr.1- Pyetësor vlerësimi për kontrollin e brendshëm dhe Formatit Standard Nr.2-“Pyetësori për Planin Strategjik –Të kuptosh procedurat e Auditimit të Brendshëm”.

Vlerësimi i riskut është bërë mbi bazën e analizës së faktorëve, si: Rëndësia dhe madhësia e subjektit të audituar; Materialiteti dhe kompleksiteti i transaksioneve; Pikëpamjet e menaxhimit; Frekuenca e auditimit; Gjetjet e auditimeve.

Gjatë hartimit të planit strategjik të veprimtarisë së NJAB-së për periudhën 2024-2026, është konsideruar vlerësimi i riskut, duke marrë në konsideratë faktorët e përmendur si më sipër, të cilët kanë mundësinë më të madhe për të shkaktuar një ngjarje të papritur që mund të ketë ndikim në arritjen e objektivave dhe natyrisht duke i dhënë prioritet fushave, të cilat kanë mundësinë më të lartë për të patur një ndikim në arritjen e objektivave.

Bazuar sa thamë më lart është i mundur identifikimi i një pjese të mirë të risqeve kryesore që institucionet i rrezikohen, sipas sistemeve si më poshtë:

#### Sistemi i prokurimeve publike / konkurrimit publik

- Mungesa e zbatimit të aktiviteteve efektive të kontrollit të gjurmës së auditimit sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore;
- Mungesa e trajnimeve në fushën e prokurimit publik;
- Mungesa e kontrolleve efektive gjatë zbatimit të kontratave.

#### Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore

- Rekrutimi i punonjësve pa procedurë transparente pa kritere vlerësimi;
- Numri i pamjaftueshëm i punonjësve për realizimin e objektivave; i cili ndër të tjera nuk mundëson ndarjen e detyrave;
- Mungesa e trajnimeve.

#### Sistemi i menaxhimit buxhetor

- Përdorimi me efektivitet i fondeve të alokuara,
- Mungesa e dokumentimit dhe respektimit të gjurmës së auditimit për çdo proces.

#### Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore





- Mungesa e vendosjes së aktiviteteve efektive të kontrollit në shërbimet që gjenerojnë të ardhura.

#### Sistemi i Kontabilitetit dhe Raportimit financiar

- Mungesa e trajnimeve në fushën e kontabilitetit publik dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit;
- Ndryshimet e shpeshta të stafit;
- Mungesa e një strategjie risku lidhur me menaxhimin e aktiveve,

#### Sistemi i menaxhimit të projekteve

- Mungesa e procedurave transparente;

#### ● Kufizimet e Auditimit

Sikurse është përmendur në shumë dokumente të Sektorit të Auditimit të Brendshëm, kufizimi kryesor, i cili ka ndikim direkt në realizimin e objektivave të Sektorit të Auditimit të Brendshëm është niveli i kualifikimit, aftësitë profesionale të stafit. Ky fakt është vërejtur në materialet e misioneve të realizuara ndonëse të pa evaduar apo të pa përfunduar, ku drejtuesit e NJAB-së e kanë ngritur dhe nuk kanë lejuar evadimin e materialeve apo kërkesat e vazhdueshme për të ndërhyrë që materiet të jenë sipas standarteve të auditimit.

- Prioritet për tre vite

Veprimtaria audituese e Sektorit të AB-së në UMT për vitet 2024-2026, do të përqëndrohet në kryerjen e angazhimeve të auditimit, sipas programimit, duke optimizuar burimet e auditimit me universin e auditimit, vlerësimin e riskut dhe frekuencën e auditimit.

Fokusi kryesor i veprimtarisë do të jenë sistemet e identifikuara me risk të mesëm.

Përveç zbatimit të Programit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Sektorin e Auditimit të Brendshëm në UMT me qëllim ushtrimin e veprimtarisë audituese në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, të pranuar për tu zbatuar në RSH, i cili vazhdon të jetë sfidë kryesore; një sfidë tjetër është fillimi i implementimit të auditimeve të performancës, si auditime mjaft të dobishme dhe me vlerë.

## **II. PLANI VJETOR I AUDITIMIT 2024**

- Zhvillimet aktuale të NJAB-së

Njësia e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023, ka funksionuar me strukturë 1(një) përgjegjës sektori dhe 2 (dy) auditues, kjo deri më 15.06.2023 dhe aktualisht funksionon me dy specialistë ku njëri i komanduar edhe me detyrën e përgjegjës të sektorit dhe vendi vakant i hedhur në sistem për tu plotësuar.

Gjatë vitit 2023, Njësia e Auditimit të Brendshëm, ka planifikur për të realizuar 4 auditime të plota deri në Dhjetor 2023 dhe aktualisht ka realizuar etëm 1 auditim të plotë. KLSH-ja ka filluar auditimin e plotë të UMT-së (në të gjitha njësitë atë qendrore Rektorat dhe atyre të vartësisë fakultete) në muajin Qershor dhe e ka përfunduar në fund të muajit shtator 2023. Nisur nga ky fakt si dhe largimi i ish Përgjegjës të Sektorit të NJAB-së në mesin e muajit Qershor, i është kërkuar BA-së ndryshim i planit vjetor 2023, ndryshim të cilin e ka miratuar dhe aktualisht është duke kryer puna në terren tek Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike si dhe angazhimi i tretë do të kryhet në muajin Nëntor-Dhjetor 2023 në Fakultetin e Mjekësisë Dentare.



Njësia e Auditimit, është megjithëse e angazhuar nuk ka arritur të realizojë planin vjetor 2023 të miratuar në fillim të vitit nga BA-ja..

- Prioritetet e auditimit për vitin 2024

Prioritet i auditimit për vitin 2024, mbetet fokusimi në sisteme dhe fusha llogarie të cilat janë vlerësuar me risk të mesëm.

Referuar vlerësimin të riskut, sipas gjetjeve në përfundim të auditimit, sekretaria mësimore e FM-së, është planifikuar për auditim gjatë vitit 2024; pasi nuk u arrit të auditohej gjatë vitit 2023. shkak për këtë është mungesa në staf dhe afati kohor.

Duke konsideruar frekuencën e auditimit dhe burimet e auditimit, gjatë këtij viti janë planifikuar kryerja e angazhimit të auditimi, që do të përfshijë 5 (pesë) subjekte.

Gjithashtu gjatë vitit 2024 do të kryhet dhe do të konsiderohet 1 (një) angazhim auditimi, verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara gjatë vitit 2023, sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 "Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik".

- Objektivat kryesore për vitin 2024

Objektivat kryesore për vitin 2024, bazuar në subjektet dhe fushat e identifikuar për auditim, janë si më poshtë:

- Të vlerësojë nëse sistemet e identifikuar për auditim po veprojnë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me objektivat specifike të vendosura nga UMT-ja;
  - Të vlerësojë sistemet e kontrollit të brendshëm, nëpërmjet komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe në përfundim të japë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e tij;
  - T'i japë prioritet fushave të vlerësuara me risk të lartë dhe të mesëm;
  - Të përmirësojë sigurimin e brendshëm të cilësisë, sipas përcaktimeve të Programit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, për të synuar zhvillimin e veprimtarisë së NJAB-së në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kartën e Auditimit, Kodin e Etikës dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi për fushën e auditimit të brendshëm.
- Programimi i llojit të angazhimeve

Universiteti i Mjekësisë në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka për detyrë konceptimin, zbatimin dhe përmirësimin e politikave të përgjithshme shtetërore për çështjet e Arsimit të Lartë. Në kryerjen e kësaj detyre, UMT-ja mbështetet nga institucionet e varësisë; të cilat funksionojnë sipas programeve përkatëse të miratuara.

Referuar mënyrës së organizimit të sistemit të UMT-së, mbështetur në eksperiencën e krijuar në vite lidhur me identifikimin e sistemeve që operojnë brenda një institucioni, duke pasur parasysh ndryshimet në aktet ligjore e nënligjore, mbi bazën e së cilës funksionon UMT-ja dhe institucionet e varësisë, fondet e alokuara për shpenzimet operative, transferata korente të brendshme, duke konsideruar edhe numrin e punonjësve, është programuar lloji i angazhimit të auditimit dhe sistemet, të cilat do të mbulohen me auditim.



Gjatë vitit 2024 janë planifikuar të kryhen 5 (pesë) angazhime auditimi; prej të cilave 4 (katër) janë auditime të kombinuara (financiare dhe përputhshmërie) dhe 1 (një) është auditim i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2023.

Në njësitë e varësisë të identifikuar për auditim, konkretisht:

- Rektorati,
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike,
- Fakulteti i Mjekësisë,
- Fakulteti i Mjekësisë Dentare

Janë identifikuar për auditim sistemet, konkretisht:

- ✓ Sistemi i pagave dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
- ✓ Sistemi i menaxhimit buxhetor;
- ✓ Sistemi i pagesave, kryerja e veprimtarisë me thesarin;
- ✓ Sistemi i prokurimeve të fondeve publike;
- ✓ Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- ✓ Sistemi i zbatimit të procedurave sipas kuotave të miratuara dhe realizimi i mbledhjes së tarifave të shkollimit sipas cikleve të studimit;
- ✓ Sistemi i zbatimit dhe përdorimit të fondit të bursave.

Për sa më sipër, angazhimet e auditimit të planifikuara gjatë vitit 2024, janë auditime të kombinuara.

- Planifikimi i kostos për vitin 2024

Bazuar në elementët e pagës aktuale të punonjësve të NJAB- sipas institucioneve të planifikuara, është përlogaritur parashikimi i kostos për vitin 2024.

Në zërin *“paga dhe sigurime shoqërore”*, është përlogaritur paga e një viti buxhetor për Përgjegjës dhe specialistët, pra referuar strukturës faktike të NJAB-së tonë, sipas përcaktimit të bërë në Udhëzuesin/shpjeguesin mbi plotësimin e Pasqyrës nr.5, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, shprehimisht: *“Burimet e planifikuara përfaqëson përlogaritjen e burimeve (ditë dhe persona) në dispozicion të NJAB-së për vitin që planifikohet”*.

Në zërin *“të tjera”* janë pasur parasysh kryesisht shpenzimet e kryera për kancelari, shtypshkrime dhe bojë printeri, pajisjen e punonjësve me pajisje të nevojshme nëse do jenë të domosdoshme. .

Të dhënat e përlogaritura janë evidentuar në vlerë në Pasqyrën nr.5, bashkëlidhur.

- Planifikimi i burimeve për vitin 2024

Planifikimi i burimeve të auditimit për vitin 2024, është përgatitur mbi bazën e burimeve njerëzore aktuale në dispozicion, të NJAB-së.

Vlen të theksojmë se burimet njerëzore të auditimit të brendshëm sipas përbërjes 1+2, në raport me subjektet e identifikuar, duke konsideruar edhe frekuencën e auditimit, janë sërish të mjaftueshme.

Për sa më sipër, gjatë Planifikimit Strategjik 2024-2026 dhe Planifikimit vjetor 2024 është synuar drejt optimizimit të subjekteve dhe sistemeve të identifikuar për auditim në raport me burimet njerëzore në dispozicion, vlerësimin e riskut dhe frekuencën e auditimit.





Gjatë ushtrimit të veprimtarisë vjetore, do të synohet ruajtja e parimit të pavarësisë funksionale dhe organizative, duke raportuar drejtpërdrejt te Bordi i Administrimit, në cilësinë e Titullarit të Njësisë Publike dhe në asnjë rast nuk mund të ngarkohen me detyra të tjera operative brenda subjektit, që nuk kanë lidhje me funksionin e auditimit, ashtu sikurse nuk mund të jenë në përbërje të strukturave të tjera operative të subjektit.

- Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Përmbushja e objektivave kryesore të strukturës sonë nuk mund të arrihet pa zhvillimin e vazhdueshëm profesional, i cili ndikon direkt në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të auditimit. Duke vlerësuar mbështetjen e deritanishme të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dëshirojmë të identifikojmë nevojat për trajnim, në temat si më poshtë:

1. Auditim i procedurave të prokurimeve publike;
2. Auditim mbi vlerësimin e riskut
3. Auditim Performancës (Eorkshop)

Meqenëse Ligji 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ka filluar efektet nga data 31 Mars 2021, është shumë i domosdoshëm trajnimi lidhur me procedurat dhe rregullat e prokurimit publik; sepse kanë ndryshuar cilësisht krahasuar me ligjin e mëparshëm.

Sistemi i prokurimeve publike është sistem i cili identifikohet me risk të lartë ose të mesëm, për këtë arsye edhe trajnimi në këtë periudhë ndryshimi të legjislacionit të prokurimeve publike, vlerësohet mjaft i domosdoshëm.

Ndonëse nuk është planifikuar auditim performance për vitin 2024, paisja me manuali/udhëzues specifik për këtë fushë, do të konsiderohet mjaft i dobishëm, por mungesa e tij e bën tepër të domosdoshëm trajnimin për auditimin e performancës duke trajtuar çështje praktike të një auditimi të tillë.

- Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Fillimi dhe zbatimi i “Programit për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Sektorin e Auditimit të Brendshëm në UMT”, do të jetë një prej sfidave të NJAB-së, jo vetëm në periudhën e tanishme, por edhe në vitet në vijim, do të jetë sigurimi i brendshëm i cilësisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**P/Njësinë e Auditimit të Brendshëm në UMT**

**Rasim METALLARI**





## SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË REKTORATIN E UMT-së

Pasqyra 1

## Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2024

Nr	Subjekte për tu audituar	Fusha për tu audituar	VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I RISKUT		
			I lartë	I mesëm	I ulët
a.	1	2	3	4	5
1	Rektorati	Sistemi i prokurimeve	I lartë		
		Sistemi i burimeve Njerëzore		I mesëm	
2	Fakulteti i Mjekësisë	Sistemi i Sekretarisë Mësimore		I mesëm	
		Sistemi i blerjeve të vogla		I mesëm	
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Ngar-kesat mësimore në në departamente, pagesat e tyre dhe të mbingarkesave		I mesëm	
4	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	Sistemi i ipasqyrave financiare dhe aseteve		I mesëm	
		Ngar-kesat mësimore në në departamente, pagesat e tyre dhe të mbingarkesave		I mesëm	
				I mesëm	

Drejtuessi i DAB-së

Raşim Metallari





## Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitet 2024-2026

SUBJEKTE TË SYNUARA PËR TU AUDITUAR SIPAS VITEVE						
Nr	Viti planifikuar 2024	Niveli i Riskut (V. planifikuar)	Viti planifikuar 2025	Niveli i Riskut (V. planifikuar)	Viti planifikuar 2026	Niveli i Riskut (V. planifikuar)
a.	1	2	3	4	5	6
1	Rektorati	I mesëm	Rektorati	I mesëm	Rektorati	I mesëm
2	Fakulteti i Mjekësisë	I mesëm	Fakulteti i Mjekësisë	I mesëm	Fakulteti i Mjekësisë	I mesëm
3	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	I mesëm	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	I mesëm	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	I mesëm
4	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	I mesëm	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	I mesëm	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	I mesëm
5	Zbatim i rekomandimeve të vitit paraardhës	I mesëm		I mesëm		I mesëm

Drejtpuesi i DAB  
Rasim Metallari





## SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË REKTORATIN E UMT -së

## Pasqyra 3

## Plani i angazhimeve të NJAB për vitin 2024

Nr	Subjekte të synuara për tu audituar	Fusha për tu audituar	Auditime Gjithsej (4.1+4.2+4.3+4.4+4.5+4.6)	Shërbimet e Sigurisë					Shërbimet e konsulencës	Grupi i Auditimit (nr.auditues)
				A. të përputhshmërisë	A. të performancës	Financiare	A.tek.Informacionit	A. të kombinuara		
a.	1	2	3	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	4.6	5
	Drejtoria Juridike dhe e B.Njerëzore pranë									
1	Rektoratit të UMT-së									
	Sistemi i burimeve Njerëzore									
	Rekretimet e personelit									
	administrativ gjatë vitit kalendarik									
	2023 dhe atij akademik me kontratë									
	për vitin akademik 2023-2024									
2	Sekretaria mësimore pranë Fakultetit të Mjekësisë	mësimore për vitin akademik 2023-2024	1					1		2
3	Strukturat akademike pranë Fakultetit të Mjekësisë Dentare	Ngarkesat mësimore në departamente, pagesat e tyre dhe të mbingarkesave dhe aseteve	1					1		2
4	Sektori i Finncës pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike Zbarrim i rekomandimeve të vitit paraardhës	Auditim i pasqyrave financiare	1			1				2
5		Në Rektorat dhe fakultete	1					1		2
	SHUMA		5	0	0	1	0	4		10

Drejtuesi i DAB  
Rasim Mersillari



## Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2024

Nr	TEMATIKA E IDENTIFIKUAR PËR TRAJNIM	Pjesëmarrës në trajnim (nr.personave)	Periudha (gjatë vitit)	Kohezgjatja e trajnimit (në ditë)
a.	1	2	3	4
1	Workshop me profesionistë të fushës së PP	3	Marsi	3
2	Njohuri mbi auditimin e Teknologjisë së Informaci	3	Prill	4
3	Njohuri mbi auditimin e performancës	3	Qershor	7
4	Identifikimi dhe vlerësimi i riskut	3	Korik	7
5	Angazhime në mbledhje dhe takime	3	Gjatë vitit 2024	3
6	Trajnimi i detyrueshëm	3	Periudha përcaktohet nga DHAB	5
	<b>SHUMA</b>			29

Drejtuesi i DAB  
 Rasim Metallari





**NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË REKTORATIN E UMT-së**

**Pasqyra 5**

**Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2024**

BURIMET E PLANIFIKUARA			BUXHETI I PLANIFIKUAR				
Nr	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore të NJAB	Ditë për tregues	Përlogaritja e burimeve	Nr	Treguesit e Kostos së Burimeve Njerëzore të NJAB	Plani	000/lekë
	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>		<b>1</b>		<b>2</b>
1	Koha maksimale e vlefshme	520	52 jave * 5 dite * 2 AB	1	Buxheti Gjithsej		15,000
2	Pushime Vjetore	56	28 dite * 2 AB	2	Paga dhe Sig. Shoqërore		15,000
3	Dite pushimi (Festa Zyrtare)	28	14 dite * 2 AB	3	Shpenzime Udhëtimi & Dieta		0
4	Pushime për arsye shëndetësore	20	10 dite * 2 AB	4	Të tjera		0
5	Angazhime në trajnime	52	26 dite * 2 AB	5	Numri i Punonjësve		2
6	Angazhime në mbledhje/takime	6	3 dite * 2 AB	6	Kosto për Person (1/3)		7.500
7	Rezerva të Planifikuara (të papritura)	4	2 dite * 2 AB				
	<b>TOTALI</b>	<b>686</b>	<b>180 ditë/person</b>				

**Drejtuesi i NJAB-së**

**Rasim Metallari**

